

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me procesmbajtesen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Emrush Suma nga fsh.Dimce ,komuna e Hani Elezit , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 22.11.2013 merr këtë;

A K T V E N D I M

I pandehuri Emrush (Nesim) Suma ,i lindur me dt.27.05.1974 ne fsh.Dimce ,komuna e Hani Elezit ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptar, shtetas i Republikes se Kosoves, I martuar prind I tre femijeve, ka te kryer fakultetin e teologjise dhe juridik , keshilltar komunal ne Asamblene komunale ne Han te Elezit ,i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gje gj ë s

Sepse si zyrtar i larte publik ne pozitën e keshilltarit komunal ne Asamblene Komunale ne Han te Elezit ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me datën 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

D E N O H E T

Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'i zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'i llogariten nga 15 (Njëzet) €

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER Korrupsionit	
AGENCIJA PROTIV Korrupcije	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	S. Prot.
Dep.	Prot. No.
Nr. f. rag.	Data
Broj stranica	Qatum
Nr. pages	Data
DPK/DMP	03-4082/13
03	27-11-2013

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit ne Prishtine , ka parashtruar kërkesen per fillimin e procedures kundervajtese nr.01-2346/12 te dates 02.07.2012 , kunder te pandehurit Emrush Suma nga Hani Elezit ,per kundervajtje nga neni 5 ,6 dhe 9 i sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.3 të Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare, dhe ka kerkuar qe I njehti te shpallet fajtor dhe te denohet sipas ligjit.

Ne baze te kerkeses se parashtruar i pandehuri eshte marre ne pyetje nga ana e gjykates me te cilin rast I pandehuri ka deklaruar se ka qene I njoftuar me kohe per obligimin e deklarimit te pasurise nga sekretari I kuvendit te komunes se Hani Elezit ,Avni Bushi ,por qe e ka neglizhur dorezimin e ketij formulari ne Agjensine Kunder Korrupsionit ,dhe dhe shton se ne asnje moment nuk ka patur per qellim qe t'I ik obligimit ligjor te deklarimit te pasurise .

Gjykata, per te konstatuar faktin se I pandehuri Emrush Shkreta a ka qene I njoftuar me kohe nga ana e zyrtareve kompetente komunal per obligimin e deklarimit te pasurise mori ne pyetje ne cilesi te deshmitarit kryesuesin e kuvendit komunal te Hani Elezit I cili ne fjalen e tij deklaroi se :keshilltari komunal Emrush Suma ka qene i njoftuar me kohe per obligimin e deklarimit te pasurise prane AKK,se ne Prishtine si nga ana e tij por edhe nga ana e sekretarit te Kuvendit te komunes se Hanit te Elezit,Avni Bushi dhe ate para dates 31.03.2012 dhe per ta vertetuar deklaraten e tij ka prezentuar para gjykates kopjen e e-mailit te sekretarit te kuvendit te komunes Avni Bushi te dates 17.03.2012,nga I cili konstatohet se keshilltari komunal Emrush Suma ka qene i njoftuar permes e-mailit te tij per obligimin e deklarimit te pasurise prane AKK,ne Prishtine.

Në bazë të dhënave si në kërkesë , deklaratës së të pandehurit , deklarates se deshmitarit Mendu Vlashi,njoftimit te dates 17.03.2012 dhe shkresave tjera te lendes , gjyqtarja konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës kundërvajtëse nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par.1 nenpar.1.1 pasi qe me Ligjin nr.04/L-050 te gjithë keshilltaret komunale te Asambleve komunale jane perfshire ne listen e zyrtareve te larte qe njeherit edhe kane obligim deklarimin e rregullt vjetor prane AKK,se ne Prishtine,dhe per mandatin sa jane ne kete pozite kane per obligim deklarimin e rregullt vjetor te pasurise se tyre, dhe rrjedhimisht obligimi I deklarimit te pasurise del sipas ligjit, edhe nese agjensioni nuk kerkon deklarimin e pasurise.

Andaj gjykata duke u bazuar ne te theksuarat me larte ka bere rikualifikimin juridik te kundervajtjes dhe te pandehurin conform nenit 17 par.1 nenpar.1 e shpalli përgjegjës dhe e dënoi me denim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , te cilin eshte e obliguar qe ta paguaje ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten conform

nenit 5 te LK,se dënimi me gjobë do t'i zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgju do t'i llogariten nga 15 (pesëmbëdhjetë) € .

Gjykata me aplikimin e nenit 9 par.1 pika 1 te pandehurit I ka shqiptuar denim me gjobe nen masen minimale te denimit te percaktuar per kete kundervajtje,pasi qe i pandehuri I ka evituar pasojat e kesaj veprë kundervajtjese duke e deklaruar pasurine e saj prane AKK,se me date 17.08.2012.

Me rastin e marrjes së aktvendimit konform nenit 7 të Ligjit për Kundërvajtje ,Gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese,kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri ,e ka permbushur obligimin e deklarimit te pasurise , dhe se ka qene hera e pare qe i njeiti ne poziten e keshilltarit komunale ka patur obligim ligjor deklarimin e pasurise prane AKK,se ne Prishtine , eshte familjar prind I tre femijeve ,ndersa rrethanë të posaqme rënduese gjykata nuk gjeti pos veprimeve të të pandehurit të cilat paraqesin elementet e veprës kundërvajtëse për të cilin është shpallur përgjegjës dhe është denuar si ne dispozitiv te ketij aktvendimi, duke vlerësuar se edhe me një denim të tillë do të arrihet efekti I sanksionimit ashtu që në të ardhmën i pandehuri t'u shmanget kryerjes së veprave të tilla apo të ngjashme kundërvajtëse.

Vendimi për shpenzimet e procedures është i bazuar në dispozitën e nenit 109 te Ligjit per Kundervajtje me të cilin rast gjykata e detyroi të pandehurin që kësaj gjykate t'i përmbush shpenzimet e procedures në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 05.00 € duke pasur parasysh nderlikueshmerine e procedurës,gjendjen materiale të pandehures,me bindjen se edhe nje denim i tille nuk do te ndikojë dukshëm ne buxhetin familjar te te pandehurit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
DEGA NE KAÇANIK**

R.I.nr.2128/2012 date 22.11.2013

Sekretarja juridike,
Indira Beqa



Keshilla juridike: Kunder ketij Aktvendimi i pandehuri
Dhe parashtuesi I kërkesës mund te paraqesin ankesë
në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimi ne
Gjykatën E apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate

